



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:114984
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05623914

P.nr.53/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit F.D, nga fshati ..., komuna Vushtrri, të cilin sipas autorizimit e mbronë av.Fatmire Braha nga Vushtrria, për shkak të veprës penale nga neni 80 i Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet - *Dënimet Penale për Aktivitet e Jashtëligjshme Minerare*, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP-II.nr.1627/16, të datës 10.01.2018, të rikualifikuar pjesërisht nga gjykata, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të datë 27.03.2024, në rivendosje, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.04.2024, përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

NDAJ TË AKUZUARIT: F.D nga i ati M, dhe e ëma Z, e gjinisë P, i lindur me datë ..., në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë, ku edhe jeton, i martuar, babai i katër fëmijëve, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion agjustator teknik i makinerisë, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës;

Në përputhje me nenin 362 paragrafi 1 pika 1.3 e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës,

REFUZOHET AKUZA

SEPSE: Në po të njëjtën datë, ditë, kohë si në pikën I të dispozitivit në kundërshtim me Ligjin për Miniera dhe Minerale si dhe të projektit për shfrytëzimin dhe elaboratin gjeologjik, duke përdorur forcën mekanike me qëllim të shfrytëzimit të resurseve minerale në kundërshtim me rregullat dhe pajisjet të cilat shërbejnë për mbrojtje nga rreziqet e tilla, me çka ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve si dhe dëm të konsiderueshëm pasuror;

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale nga neni 80 i Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet - *Dënimet Penale për Aktivitet e Jashtëligjshme Minerare*.

Shpenzimet procedurale bien barrë e buxhetit të kësaj gjykate.

Pala e dëmtuar Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP-II nr.1627/16, të datës 10.01.2018, ndaj të pandehurve F.D, nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, L.D, nga fshati ..., komuna Obiliq, si dhe të akuzuarit R.A, nga fshati ..., komuna Vushtrri, për shkak të veprës penale *Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit* nga neni 347 par.1 të KPRK-së, si dhe veprës penale *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm* nga neni 365 par.2 të KPRK-së.

Gjykata pas tentimit të mbajtjes së 20 seancave dhe dështimit të tyre kryesisht për shkak të mungesës së prokurorit të shtetit e disa herë për shkak të mungesës së të pandehurve, për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës, me rastin e mos paraqitjes në dy seanca radhazi të të pandehurit F.D dhe mbrojtëses së tij av.Fatmire Braha, në seancën e datë 09.10.2023, gjykata me qenë se janë plotësuar kushtet ka vazhduar seancën për të pandehurit L.D dhe R.A, ndërsa ka veçuar procedurën ndaj këtu të pandehurit F.D, ku procedura është udhëhequr sipas numrit të ri të kësaj lënde P.nr.285/23.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale ka vendosur me Aktgjykimin P.nr.285/23 të datës 01.12.2023, i cili është anuluar pjesërisht, sa i përket pikës II të dispozitivit, me Aktvendimin PA1.nr.108/24 të Gjykatës së Apelit, dhe çështja është kthyer në rivendosje, sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

Gjykata pasi çështja është kthyer në rivendosje, lidhur me këtë çështje penale me datë 27.03.2024 ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit, i pandehuri F.D dhe mbrojtësja e tij av.Fatmire Braha. Të pandehurit pas leximit të aktakuzës dhe pasi gjykata është bindur se i njëjti e kanë kuptuar aktakuzën dhe udhëzimet e gjykatës, i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ku i pandehuri ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë sipas aktakuzës.

Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor janë paraqitur fjalët hyrëse dhe në procedurën e provave, me pëlqimin e palëve janë lexuar deklaratat e dëshmitarëve S.M dhe R.M të dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 01.11.2023, janë administruar provat materiale dhe janë paraqitur fjalët përfundimtare të palëve. I pandehuri ka zgjedhur të mbrohet në heshtje.

I pandehuri sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1627/16, në pikën II të saj akuzohet për kryerjen e veprës penale *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm* nga neni 365 par.2 të KPRK-së.

Gjykata pasi bëri shqyrtimin dhe vlerësimin e fakteve dhe provave në shkresat e lëndës në njërën anë dhe bazës juridike në anën tjetër, gjeti se është e nevojshme që lidhur me të pandehurin F.D

të bëhet rikualifikimi i veprës penale sa i përket pikës II të aktakuzës, përkatësisht lidhur me veprën penale *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm* nga neni 365 par.2 të KPRK-së.

Arsyet lidhur me rikualifikimin e veprës penale

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me këtë çështje penale ka administruar këto prova:

Prova personale: Dëgjimin e dëshmitarit S.M dhe dëshmitarit R.M.

Prova materiale: Raporti për aktivitetin e jashtëligjshëm minerar, nr. 10738; Urdhëresa për ndërprerje të aktivitetit minerar për të pandehurin F.D, datë 13.07.2016; Raporti i terrenit, datë 13.07.2016; Raporti i kalkulimit të vëllimit datë 22.07.2016; Raporti i veprimt ilegal për të pandehurin F.D, datë 22.07.2016; Aktvendimi për shqiptimin e gjobës administrative datë 23.08.2016; Procesverbali mbi marrjen ne pyetje të të pandehurit F.D, datë 22.01.2018.

Nga deklarata e dëshmitarit S.M gjykata ka vërtetuar se dëshmitari si zyrtarë policorë ka marrë urdhëresën nga baza që të shkojnë në fshatin ..., sepse në mënyrë ilegale, me eskavator po nxirrej thëngjill dhe kur kanë shkuar i kanë hasur të pandehurin F.D dhe L.D duke nxjerrë thëngjill në mënyrë ilegale dhe e kanë informuar njësitin hetues të cilët më pas kanë dal në vendin e ngjarjes dhe nga ai moment janë marrë njësi hetues me rastin, të cilët edhe e kanë lajmëruar Komisionin e pavarur për Miniera dhe Minerale, me ç'rast në vend ngjarje kanë dalur inspektorët M.M dhe R.M të cilët edhe i kanë shqiptuar gjobë të pandehurit.

Nga deklarata e dëshmitarit R.M gjykata ka vërtetuar se dëshmitari si inspektorë i KPMM është informuar nga policia se është hasur një person duke nxjerrë thëngjill në mënyrë ilegale, dhe ku dëshmitari ka shkalur në vendngjarje e ka pyetur të pandehurin nëse ka licencë të shfrytëzimit, pavarësisht se e di se asnjë person fizik e as juridik nuk posedon licencë të shfrytëzimit, pasi KPMM nuk lëshon këto licenca, dhe i pandehuri është përgjigjur se nuk posedon licencë. Më tutje dëshmitari ka deklaruar se ka lëshuar urdhëresë për ndërprerjen e aktivitetit ilegal minerar dhe raport terreni, dhe se në vendin e ngjarjes janë hasur një eskavator dhe një kamion siç edhe shihet nga foto dokumentacioni aty është hapur një gropë e madhe e shfrytëzimit të thëngjillit.

Nga deklarimi i dëshmitarëve si dhe nga administrimi i provave materiale, gjykata vlerëson se me veprimet e të pandehurit nuk përmbushen elementet e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri F.D.

Andaj, gjykata pasi bëri shqyrtimin dhe vlerësimin e fakteve dhe provave në shkresat e lëndës në njërën anë, dhe bazës juridike në anën tjetër, gjeti se është e nevojshme që të bëhet rikualifikimi i veprës penale sa i përket pikës II të aktakuzës për të pandehurin F.D, përkatësisht lidhur me veprën penale *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm* nga neni 365 par.2 të KPRK-së.

Neni 365 par.1 përcakton se formën themelore të veprës penale *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm* e kryen “*Kushdo që me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me ndonjë lloj*

energjie tjetër, ose me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme, shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.”, ndërsa paragrafi 2 me të cilin edhe ngarkohet i pandehuri sipas pikës II të aktakuzës përcakton formën e kualifikuar të kësaj veprë penale ku parashihet se “Kushdo që në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara me ligj nuk i vendos pajisjet për mbrojtjen nga zjarri, vërshimi, eksplozimi, helmimi ose për mbrojtjen nga gazrat helmuese, rrezatimi jonizues, forcat mekanike, energjia elektrike ose nga ndonjë lloj energjie tjetër, ose me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme, apo këto pajisje nuk i mirëmban në gjendje të rregullt apo nuk i vë në përdorim ose në përgjithësi nuk vepron sipas rregullave ose rregulloreve teknike mbi masat mbrojtëse dhe me këtë shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej një(1) deri në pesë (5) vjet”.

Në rastin konkret gjykata nuk e gjenë të zbatueshme dispozitën e nenit 365 paragrafi 2 ashtu siç është kualifikuar nga ana e prokurorit të shtetit, për shkak se fryma e kësaj dispozite na dërgon në interpretimin se kryes i kësaj veprë penale mund të jetë ai person në fushëveprimin e të cilit bie edhe kujdesi për vendosjen, mbajtjen në gjendje të rregullt dhe përdorimin e masave mbrojtëse, rrjedhimisht kryerja e mbikëqyrjes në marrjen e këtyre masave. Përkatësisht veprimi i kësaj forme të veprës penale është i përcaktuar në mënyrë alternative dhe përfshin, para se gjithash, mosveprimin sipas obligimeve të caktuara, të cilat kryesi i ka përkitazi me pajisjet mbrojtëse – mos vendosja e tyre, mos mbajtja e tyre në gjendje të rregullt ose mosvënia në funksion e këtyre pajisjeve. E që në rastin konkret i pandehuri nuk ka qenë person që ka pasur obligime të caktuara në raport me pajisjet mbrojtëse, sepse në radhë të parë nuk ka qenë fare i licencuar ashtu siç e parasheh Ligji për Miniera dhe Minerale, në mënyrë që të ketë obligime për aplikimin e masave mbrojtëse në ushtrimin e autorizimeve të tij që do të rridhnin nga një leje – licencë e dhënë nga organi përkatës kompetent.

Ndërsa gjykata nuk gjeti se mund të zbatohet as forma themelore e kësaj veprë penale e përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 365, për shkak të elementeve që kërkohet të përmbushen dhe në rastin konkret në përshkrimin e veprimeve të të pandehurit nuk përmbushen potencialisht asnjë nga elementet e figurës së kësaj veprë penale. Kjo pasi që sipas Kodit Penal, forma themelore e veprës penale *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm* kryhet kur me veprime specifike shkaktohet rrezik i madh për jetën e njerëzve apo dëm i konsiderueshëm pasuror, e që në rastin konkret Prokuroria nuk ka arritur të provojë se me veprimet e të pandehurit është shkaktuar rrezik i madh për jetën e njerëzve, e as dëm i konsiderueshëm pasuror (mbi 5.000 euro), dhe nga provat e ofruara gjykata vlerëson se nuk janë përmbushur as elementet e formës themelore të veprës penale *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm*.

Në anën tjetër gjykata gjeti se në mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje, pasojat e veprimeve të tilla të ushtrimit të aktivitetit mineral pa licencë, e për të cilat dyshohet ti ketë kryer edhe i pandehuri, janë paraparë me nenin 70 dhe 80 të Ligjit nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale si dhe nenin 43 dhe 49 të Ligjit nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale. Kjo sepse neni 70 par.1 i Ligjit të lartë cekur parasheh se “Nëse një inspektor i autorizuar ka arsye të mira për të besuar se një person është duke ushtruar aktivitete të

hulumtimit, shfrytëzimit ose aktivitete të veçanta dhe se ky person nuk posedon Licencë ose Leje nga KPMM, inspektori menjëherë e informon Policinë e Kosovës e cila menjëherë dërgon së paku dy zyrtar policor në vendin e ngjarjes”, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni parasheh se “Nëse asnjëri nga këta persona ose punëdhënësi i tyre (nëse kanë punëdhënë) nuk posedojnë Licencë ose Leje nga KPMM, zyrtarët e policisë i arrestojnë Personat në fjalë të cilëve më pas u shqiptohet gjoba administrative e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 79 të këtij ligji dhe dënimet penale sipas Nenit 80 të këtij ligji. Përveç kësaj, inspektori sekuestron të gjitha mjetet punuese dhe mineralet e nxjerra që gjenden në vendin e rastit”. Më tutje neni 80 par.1 i këtij Ligji parasheh se “Çdo personi i cili angazhohet ose i cili inkurajon ose punëson persona tjerë për t’u angazhuar në aktivitete të shfrytëzimit ose hulumtimit të mineraleve pa posedimin e një Licence ose Leje nga KPMM, i shqiptohet gjoba administrative e përcaktuar në paragrafin 2. nën-paragrafi 2.1. të nenit 79 të këtij ligji dhe një masë burgimi deri në gjashtë (6) muaj”.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e Prokurorisë Themelore të dhëna në fjalën përfundimtare sa i përket asaj se shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm për jetën e njerëzve është shkaktuar duke hapur gropa të mëdha, siç edhe shihet në foto dokumentacionin nga vendi i ngjarjes, mirëpo gjykata vlerëson se këto pretendime nuk janë të bazuara, pasi që nga foto dokumentacioni shihet gropimi që është bërë për nxjerrjen e thëngjillit, me çka gjykata ka vërtetuar elementet e veprës penale të paraparë në nenit 80 të Ligjit nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale, mirëpo gjykata vlerëson se me atë grupim, me qëllim të nxjerrjes së thëngjillit nuk janë plotësuar elementet e veprës penale *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm*, pasi që siç u theksua edhe më lartë, nuk është vërtetuar se është shkaktuar rrezik për jetën e njerëzve e as dëm i konsiderueshëm pasuror.

Andaj gjykata ka gjetur se në rastin konkret duhet të zbatohen dispozitat e ligjit special që rregullon aktivitetin në miniera dhe minerale pra Ligjit nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale, e që edhe sipas Komentarit të Kodit Penal, si burim subsidiar i të drejtës, zbatimi i normës së nenit 365 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ekziston vetëm po qe se me kryerjen e saj nuk është realizuar ndonjë veprë penale e posaçme kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë.

Arsyet lidhur me refuzimin e akuzës

Për veprën penale të rikualifikuar nga gjykata me të cilën ngarkohet i pandehuri, nga neni 80 i Ligjit për Miniera dhe Minerale, parashihet dënim me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj.

Gjykata pasi konsultoj dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, gjeti se në këtë çështje penale ka arritur parashkrimi absolut i veprës penale, kjo duke u bazuar në nenin 106 par.1 pika 1.6, i cili përcakton se “Përveç nëse shprehimisht parashihet ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet e mëposhtme: 1.6. dy (2) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një (1) vit burgim ose me dënim me gjobë”, ndërsa neni 107 par.8 përcakton se “Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit”.

Në rastin konkret nga koha kur dyshohet se është kryer vepra penale nga neni 80 i Ligjit për Miniera dhe Minerale, e dënueshme me dënim me burgim deri në 6 muaj, kanë kaluar më shumë se 7 vite, e që në rastin konkret është arritur dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit i paraparë me nenin 106 par.1 pika 1.6, në lidhje me nenin 107 par.8 të KPPRK-së.

Neni 362 i KPPRK-së, përcakton se “Gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur: ka kaluar afati i parashkrimit dhe vepra përfshihet në amnisti ose falje, ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që përjashtojnë ndjekjen penale”, andaj me rastin e konstatimit të arritjes së afatit absolut të parashkrimit të veprave penale me të cilat ngarkohet i pandehuri, gjykata veproj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke refuzuar akuzën.

Në rast të atakimit të këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së dytë në vështrim të dispozitave të nenit 398 të KPPRK-së, mund ta ndryshojë këtë vendim.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori konform nenit 453 par.1 të KPPRK-së, ndërsa vendimin lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata e mori në bazë të nenit 462 par.3 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë, e bazuar në nenin 362 par.1, nën par.1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.53/2024, datë: 26.04.2024

Zyrtarja ligjore
Arta Jusufi

Gjyqtari vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.